

VENDIM
Nr.589, datë 29.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.828, DATË 30.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË
USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, NË FORMËN E SKRAPEVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, bëhet ky ndryshim:

Në lidhjen A, në listën që i bashkëlidhet vendimit, numri rendor 2 “Nëndetësja 332 tufani”, numri rendor 10 “Katër silurues 302 Patrioti”, numri rendor 11 “Katër silurues 303 Delfini”, numri rendor 13 “Katër silurues 307 Luftëtari”, numri rendor 15 “Katër silurues 309 Heroi”, numri rendor 16 “Katër silurues 310 Trimi”, dhe numri rendor 25 “Rimork detar 253 M.Ulqinaku”, hiqen nga lista dhe i kalojnë, për qëllime muzeale, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2.Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha